




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gjiçane Belediyesi

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/04 qershor 2008), nenit 78 të Statutit të Komunës së Gjiçanit (01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014 me Ndryshimet dhe Plotësimet e Statutit 01. nr. 016-28448 të datë 22.03.2018), Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M **PËR EMËRTIMIN E KOMISIONIT PËR INSPEKTIM FINAL TË PUNËVE** **NDËRTIMORE**

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni për inspektim final të punëve ndërtimore në objektin banesorë-afarist 4, të ndërtuar nga investitori: “Vëllezërit Borovci” SH.P.K., me pronarë: Mustaf Borovci dhe Kamer Borovci, sipas Lejes Ndërtimore Nr.07-350-112271 datë 16.11.2018, me etazhitet “B+P+7” Lam. A dhe B, në kuadër të parcelave kadastrale P-70403013-02028-17, 05082-1 dhe 02028-28 , Zona Kadastrale Gjiçane, tek vendi i quajtur Fidanishte.

Neni 2

Komisioni i emëruar përbëhet prej gjashtë (6) anëtarëve:

- | | |
|----------------------|--|
| - Ridvan Aliu | Inxh. i Dip. Ndërtimtarisë - kryetar |
| - Edon Haziri | Inxh. i Dip. Arkitekturës - anëtar, |
| - Kimete Salihu | Inxh. i Dip. Hidros - anëtar, |
| - Arbër Shabani | Inxh. i Dip. Elektros - anëtar, |
| - Bejtullah Krasniqi | Inxh. i Dip. Makinerisë - anëtar, |
| - Ahmet Daku | Msc. i Shkencave të sigurisë - anëtar. |

Neni 3

Komisioni ka për detyrë që të vërtetoj nëse ndërtimi është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejes Ndërtimore Nr.07-350-112271 datë 16.11.2018, si dhe evidenton mbajtjen e librit ndërtimor, ditarin ndërtimor dhe atestet e materialeve

të përdorura që janë në përputhshmëri me Kodin e ndërtimit, standardin dhe legjislacionin tjetër përkatës.

Neni 4

Investitori është i obliguar që komisionit të i ofroj në dispozicion tërë dokumentacionin teknik si dhe:

- Raportin përfundimtar të punëkryesit, me konstatimin se punët janë kryer në tërësi,
- Raportet e realizimit të punëve ndërtimore nga secili inxhinier mbikqyrës i fazës së ndërtimit, me të cilin merr përsipër se punët janë kryer plotësisht sipas projektit, në përputhje të plotë me Lejen e Ndërtimit,
- Incizimin gjeodezik të objektit të ndërtuar së bashku me rregullimin e partitit
- Atestet dhe certifikatat e materjaleve të përdorura, e nëse komisioni e sheh të arsyshme edhe ateste dhe analiza shtesë të marra në prezencën e komisionit,
- Vlerën investive.

Neni 5

Për inspektimin e bërë, secili anëtar i komisionit është i obliguar të përpiloj raport individual mbi inspektimin e bërë në bazë të cilave Komisioni duhet të përpiloj procesverbal përfundimtar, ku në rastin konkret duhet të konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht se mund të përdoret apo jo.

Neni 6

Komisioni ka për detyrë që të i raportoj Kryetarit të Komunës.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit Komunal.

